

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7-21



IDRO POWER SERVICE sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018**

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3,814,989	1,033,465
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	-	148,532
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	93,603,918	42,568,812
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	30,910	834,725
Inventarë	8	2,853,606	5,823,805
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	216,388	
Totali i aktiveve afatshkurtra		100,519,811	50,409,339
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	10	7,930,092	4,694,523
Totali i aktiveve afatshkurtra		7,930,092	4,694,523
Totali i aktiveve		108,449,903	55,103,862
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	19,810,070	15,211,139
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	13,036,880	13,496,918
Detyrime tatimore	13	2,637,375	4,636,682
Të tjera detyrime	14	1,045,997	836,556
Totali i detyrimeve afatshkurtra		36,530,322	34,181,295
Detyrime afatgjatë			
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		36,530,322	34,181,295
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		1,500,000	100,000
Rezerva ligjore		10,000	
Rezerva të tjera		20,812,566	
Fitimi i ushtrimit		49,597,015	20,822,567
Totali i kapitalit	15	71,919,581	20,922,567
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		108,449,903	55,103,862

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

IDRO POWER SERVICE SH.p.k.
Rr. "Emin Duraku" - P. Binjakët
nr.5, Tirane

R

Idro Power Service sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	199,447,927	86,020,363
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	(2,103,832)	(158,821)
Total të ardhura		197,344,095	85,861,542
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(125,853,948)	(55,374,285)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	18	(120,753,418)	(53,662,449)
2) Të tjera shpenzime	19	(5,100,530)	(1,711,836)
Shpenzime të personelit	20	(10,995,615)	(5,429,723)
1) Paga dhe shpërblime		(9,640,106)	(4,812,810)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,355,509)	(616,913)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(1,544,507)	(297,600)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(1,850)	(20,000)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare		(470,927)	(202,301)
1) Shpenzime Interesi dhe shpenzime të ngjashme	22	(470,927)	(202,301)
Fitimi/humbja para tatimit		58,477,248	24,537,633
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(8,880,233)	(3,715,066)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	23	(8,880,233)	(3,715,066)
Fitimi/humbja e vitit		49,597,015	20,822,567
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		49,597,015	20,822,567

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

IDRO POWER SERVICE SH.p.k.
Rr. "Emin Duraku" - P. Binjakët
nr.5, Tirane

R

Idro Power Service sh.p.k


(Vlerat janë në Lek)


**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitim / Humbja e vitit	Total
Pozicioni financiar më 1 janar 2017	100,000	-	-	-	100,000
Fitim/Humbja e vitit	-	-	-	20,822,567	20,822,567
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	-	-	20,822,567	20,922,567
Transferim në fitime të mbartura	-	-	-	-	-
Rezerva ligjore dhe te tjera	-	10,000	20,812,566	(20,822,566)	20,822,566
Fitimi i vitit	-	-	-	49,597,015	49,597,015
Shtesa kapitali	1,400,000	-	-	-	1,400,000
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	1,500,000	10,000	20,812,566	49,597,015	71,919,581

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i Idro Power Service sh.p.k më 13/03/2019 dhe janë firmosur si më poshtë.


Giordano Gorini
 Administrator
IDRO POWER SERVICE SH.P.K.
 Rr. "Emin Duraku", P. Binjaket
 nr.5, Tirane


Nexhmije Saraçi
 Financiere

Idro Power Service sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	58,477,248	24,537,633
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	(1,136,217)	(3,715,066)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,544,507	297,600
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(50,299,147)	(43,552,069)
Rënie/(rritje) në inventarë	2,970,199	(5,823,805)
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra		
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	2,139,585	33,749,323
Tatim mbi fitimin e paguar	(7,744,016)	-
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	209,441	431,972
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	6,161,600	5,925,588
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(4,780,076)	(4,992,123)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(4,780,076)	(4,992,123)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	1,400,000	100,000
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	1,400,000	100,000
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	2,781,524	1,033,465
Mjetet monetare në fillim të periudhës	1,033,465	-
Mjetet monetare në fund të periudhës	4 3,814,989	1,033,465

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

IDRO POWER SERVICE SH.p.k.
 "Emin Duraku" P. Bimjakët
 nr.5, Tiranë

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Idro Power Service" Sh.p.k është krijuar më 24/07/2017 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" dhe nga statuti i saj.

Kapitali i Shoqërisë është 1,500,000 lek. "Idro Power Service" sh.p.k është një shoqëri shqiptare me ortakë:

- Giordano Gorino - zotëron 10% të pjesëve të kapitalit
- Hydra Energia - zotëron 90% të pjesëve të kapitalit

Administrator i Shoqërisë është z. Giordano Gorini për periudhën nga 24/07/2017 deri në 24/07/2022. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr 5, Rruga Emin Duraku, Pallati "Binjakët", Nr 5. Ajo është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore të rrethit Tiranë me NIPT L71926004C.

Aktiviteti kryesor i kësaj Shoqërie është prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike; projektimi, ndërtimi i centraleve për prodhimin e energjisë elektrike; furnizimi i shërbimeve me asistencë teknike, mirëmbajtje dhe riparim të të gjitha makinerive dhe pajisjeve, duke përfshirë asistencën teknike, mirëmbajtjen e riparimin e çdo lloj ndërtese; kërkimi dhe zhvillimi i sistemeve për të përmirësuar prodhimin, trainime profesionale dhe për menaxhim, në favor të personelit, të bashkëpunëtorëve në interes të nevojave të Shoqërisë; pjesëmarrja në programe ndërkombëtare për bashkëpunim dhe partnership me kompani dhe operatorë të KE për të implementuar programe specifike. Import-eksport, tregtimi me pakicë dhe shumicë i makinerive, pajisjeve, aparaturave dhe mallrave në lidhje me kryerjen e aktivitetit të Shoqërisë. Konsulencë teknike, administrative, menaxhuese dhe të çdo lloji natyre tjetër të lidhur me objektin e Shoqërisë.

Në 31 dhjetor 2018 shoqëria ka 9 punonjës (2017: 9).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa-mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatit e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
EUR/LEK	123.42	132.95
USD/LEK	107.82	111.10

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të maturë me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4 Aktive afatgjata material (vazhdim)**

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Instrumenta dhe vegla	Vlera e mbetur	20 %
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mjete monetare ne bankë	3,813,852	626,375
Mjete monetare ne arkë	1,137	407,090
	<u>3,814,989</u>	<u>1,033,465</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Kliente brenda vendit	-	148,532
	<u>-</u>	<u>148,532</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Klientë për palë të lidhura	93,603,918	42,568,812
	<u>93,603,918</u>	<u>42,568,812</u>

Idro Power Service sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Dogana	30,910	9,725
Paradhënie furnitorë	-	825,000
	<u>30,910</u>	<u>834,725</u>

8. Inventari

Inventarët më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Materiale të para	2,818,006	5,604,274
Materiale ndihmëse	-	164,171
Lëndë djegëse	35,600	55,360
	<u>2,853,606</u>	<u>5,823,805</u>

9. Shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime të shtyra	216,388	-
	<u>216,388</u>	<u>-</u>

Idro Power Service sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

Kosto	Instrumenta dhe vegla pune	Mjete transporti	Pajisje informatike	Totali
Gjendja më 1 janar 2017				
Shtesa	1,201,619	3,790,504	-	4,992,123
Transferime				
Pakësime				
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,201,619	3,790,504	-	4,992,123
Shtesa	671,818	3,987,983	120,274	4,780,075
Transferime				
Pakësime				
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,873,437	7,778,487	120,274	9,772,197
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2017				
Amortizimi i vitit	44,900	252,700	-	297,600
Pakësime				
Gjendja më 31 dhjetor 2017	44,900	252,700	-	297,600
Amortizimi i vitit	291,624	1,239,292	13,591	1,544,507
Pakësime				
Gjendja më 31 dhjetor 2018	336,524	1,491,992	13,591	1,842,107
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,156,719	3,537,804	-	4,694,523
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,536,913	6,286,496	106,683	7,930,092

11. Llogaritë e pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Furnitorë brenda vendit	17,652,910	13,906,414
Furnitorë jashtë vendit	2,157,160	1,304,725
	<u>19,810,070</u>	<u>15,211,139</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Hydra Energia s.r.l	11,728,380	12,144,549
Giordano Gorini	1,308,500	1,352,369
	<u>13,036,880</u>	<u>13,496,918</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	187,702	218,360
Tatim mbi të ardhurat personale	268,069	213,611
TVSH për tu paguar	961,567	420,674
Tatimi në burim	83,820	68,971
Tatim Fitimi	1,136,217	3,715,066
	<u>2,637,375</u>	<u>4,636,682</u>

14. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Paga dhe shpërblime	1,045,997	836,556
	<u>1,045,997</u>	<u>836,556</u>

15. Kapitali

Struktura e kapitaleve të veta paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018			31 dhjetor 2017		
	Nr i pjesëve	Vlera e kapitalit	Në %	Nr i pjesëve	Vlera e kapitalit	Në %
Hydra Energia	1	1,350,000	90%	1	90,000	90%
Giordano Gorini	1	150,000	10%	1	10,000	10%
	2	1,500,000	100%	2	100,000	100%

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerë 1,500,000 lekë.

Fitimi i ushtrimit

Shoqëria ka fitim më 31 Dhjetor 2018 prej 49,597,015 Lekë (2017: 20,822,567 LEK).

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shërbime studimi dhe konsulence	15,267,100	6,692,100
Shërbime mirëmbajtjeje	74,223,716	10,350,113
Kryerje punimesh	109,957,111	68,978,151
	199,447,927	86,020,364

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	31 dhjetor 2018
Qarkullim i tatueshëm	203,912,656
Zbriten Autofaturat	(4,464,729)
Shtohen diferencat e kursit të këmbimit të përfshira në zërin të ardhura të tjera	(2,103,832)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	197,344,095
Sipas Kontabilitetit	197,344,095
Diferenca	-

17. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar. Ato detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fitim nga këmbimet valutore	1,325,364	198,885
Humbje nga këmbimet valutore	(3,429,196)	(357,707)
	(2,103,832)	(158,822)

18. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Kosto e materialeve të para	19,649,684	24,645,854
Konsulencë teknike	1,218,671	400,980
Nënkontraktorët	94,875,334	25,784,223
Shpenzime udhëtimi dieta	2,115,810	793,500
Shpenzime transporti	1,439,122	1,861,420
Qera Magazine	705,888	176,472
Primi sigurimit	550,909	-
Shërbime topografike	198,000	-
	120,753,418	53,662,449

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Konsulencë dhe noterizime	928,180	235,225
Taksa vendore e të tjera	240,668	138,985
Shpenzime të ndryshme	794,947	36,734
Shërbime bankare	139,041	91,477
Shpenzime kancelarie	-	35,700
Mirëmbajtje dhe riparime	2,806,402	862,015
Primi sigurimit	-	19,800
Shërbime për pritje percjellje	126,520	246,000
Qera automjeti	64,772	45,900
	5,100,530	1,711,836

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime paga	9,640,106	4,812,810
Shpenzime per sigurime shoqërore	1,355,509	616,914
	<u>10,995,615</u>	<u>5,429,724</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2018 është 9 (2017: 9).

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penaltetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime gjoba dhe penaltetete	1,850	20,000
	<u>1,850</u>	<u>20,000</u>

22. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime interesi dhe te ngjashme	470,927	202,301
	<u>470,927</u>	<u>202,301</u>

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2017: 15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruar për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Në përcaktimin e rezultatit tatimor Shoqëria ka marrë në konsideratë shpenzimet e panjohura për efekte fiskale. Ato lidhen me:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fitimi para tatimit	58,477,248	24,537,633
Total shpenzime të panjohura	724,307	229,471
Shpenzime restoranti	132,755	6,450
Gjoha dhe penalitete	1,850	20,000
Shpenzime për interesa financimi		202,301
Shpenzime të tjera	589,702	720
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	59,201,555	24,767,104
Tatim fitimi @15%	8,880,233	3,715,066
Fitim/humbja e vitit	49,597,015	20,822,567

24. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura përfaqësojnë transferim të burimeve, shërbimeve, ose detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse vendoset apo jo një çmim. Një palë e lidhur është një palë, e cila kontrollon, kontrollohet, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë tregtare; ka një interes mbi njësinë që i jep një influencë të rëndësishme mbi entitetin; ose ka një kontroll të lidhur mbi entitetin; është ortak në shoqëri; është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën entiteti është sipërmarrës; ose është një anëtar i personelit drejtues të entitetit, ose mëmës së tij (duke përfshirë familjarët e afërm të çdonjërit prej individëve të sipërpërmendur). Gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2018, shoqëria ka kryer transaksione me palët e lidhura të cilat rezultojnë në shumatat e mëposhtme:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Albanian Green Energy	15,494,046		3,464,059	-
Balkan Green Energy	78,109,871		39,104,754	-
Furnitor/Hydra Energia S.R.L	-	620,580	-	12,144,549
Ortak/ Hydra Energia S.R.L	-	11,107,800	-	-
Giordano Gorini	-	1,234,200	-	1,352,369
Furnitor/ Interesa	-	74,300	-	-
	93,603,916	13,036,881	42,568,812	13,496,918

23. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Albanian Green Energy	59,333,273	-	34,025,030	-
Balkan Green Energy	135,874,382	-	51,871,138	-
Hydra Energia S.R.L	-	417,853	-	179,432
Hydra Energia S.R.L	-	90,639	-	-
Giordano Gorini	-	53,071	-	22,869
	195,207,655	561,562	85,896,168	202,301

24. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.